



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**NJOFTIM PËR MEDIA**

Ditën e martë, në datën 4 tetor 2022, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive, AMA u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Armela</b>	<b>KRASNIQI</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Aurela</b>	<b>BICJA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Besian</b>	<b>ZOGAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Gjergji</b>	<b>HAMITI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Jetmir</b>	<b>HALILAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Joana</b>	<b>ALLUSHI</b>	<b>Anëtar</b>

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të shoqërisë “Fokus Cable” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Fokus”. **(Vendimi nr. 107, datë 04.10.2022)**
2. Mosrinvimin e licencës së shoqërisë “Intel Media” sh.p.k., për subjektin audio privat vendor “Radio Jug”. **(Vendimi nr. 108, datë 04.10.2022)**
3. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “SCAN” sh.a, licencuar për subjektin audioviziv privat “Tv SCAN”, dhe për subjektin audio “Radio Alpet”, duke miratuar ndryshimet në strukturën e pronësisë së këtij subjekti. **(Vendimi nr. 109, datë 04.10.2022)**
4. Pranimin e kërkesës së subjektit, shoqërisë “ALBTELECOM” sh.a., autorizuar për ofrimin e shërbimeve audiovizive, duke miratuar ndryshimet në strukturën e pronësisë së këtij subjekti. **(Vendimi nr. 110, datë 04.10.2022)**
5. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “TV M DEVOLLI” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor M DEVOLLI”, duke miratuar ndryshimet në strukturën e pronësisë së këtij subjekti. **(Vendimi nr. 111, datë 04.10.2022)**
6. Pranimin e kërkesës së subjektit, shoqërisë “Fastnet Albania” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “TV Kabllor Fastnet”, për reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit duke hequr nga zona e ofrimit “Njësinë administrative Shalës”. **(Vendimi nr. 112, datë 04.10.2022)**

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**Tiranë, më 04 tetor 2022**